



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

I. NJOFTIMI I KONTRATËS QË PUBLIKOHET NË BULETININ E NJOFTIMEVE PUBLIKE DHE NË FAQEN ZYRTARE TË AUTORITETIT KONTRAKTOR

Seksioni 1. Autoriteti Kontraktor

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm
Adresa Rr. "Qemal Stafa", nr.1, tiranë
Tel/Fax 04 2282012
E-mail enkeleida.zotkaj@pp.gov.al
Faqja e Internetit www.pp.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedura e thjeshtuar e prokurimit - prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

3. Objekti i kontratës: "Kolaudim i punimeve me objekt rikonstruksion i godinës dhe ndërtim i ri i rrjetit elektrik dhe kompjuterik, i klasifikuar" për Prokurorinë e Përgjithshme.

4. Numri i referencës së procedurës: Urdhri i prokurimit nr. 90, datë 07.12.2021.

5. Fondi limit: 183,630 (njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë) leke pa TVSH.

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutim:

Kohëzgjatja në muaj ☐ ☐ ose ditë 30 (tridhjetë) dite kalendarike.

ose

duke filluar nga ☐ ☐ / ☐ ☐ / ☐ ☐ ☐ me përfundim në ☐ ☐ / ☐ ☐ / ☐ ☐ ☐.

7. Afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:

14/12/2021 (dd/mm/vvvv) Ora: 10:00

Prokuroria e Përgjithshme, adresa: Rr."Qemal Stafa", nr. 1, Tiranë

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët ☒

Ose

B) oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

lidhur me rëndësinë: Çmimi ☐ **pikë** ☐

Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip ☒ Anglisht ☐
Tjetër _____

Kjo procedurë prokurimi do të zhvillohet në bazë të ligjit nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë” dhe vendimit të KM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.

➤ Kandidatët e interesuar duhet të jenë të pajisur me Certifikatën e Sigurimit Industrial (CSI), e cila duhet të jetë:

- Jo më e ulët se niveli i klasifikimit “Sekret”;
- E vlefshme në momentin e prokurimit dhe të lidhjes së kontratës së klasifikuar;
- Në përputhje me objektin specifik të prokurimit të klasifikuar.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit(statusi aktiv)/në një regjister tregtar profesional në shtetin e tij të origjines ose të qendrimit dhe në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është subjekt i procedimeve për deklarimin e falimentit, për një urdhër likuidimi apo administrimit të detyrueshëm nga një gjykatë apo rregullimi me kreditorë apo ndonjë procedim të ngjashëm sipas legjislacionit në fuqi.
- c) nuk ka falimentuar (statusi aktiv)ose nuk është në likuidim.
- d) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 38/1 të LPFMS.
- e) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi/legjislacionit të vendit të origjinës.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim ose nëpërmjet vërtetimit të dokumentave.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari i ofertes ekonomike;*
- b. *Deklaratën për përmbushjen e specifikimeve teknike;*
- c. *Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit*
- d. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës.*

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti Ligjor / profesionali operatorëve ekonomikë:

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë, Liçensë profesionale të vlefshme për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi” (sipas modelit të lëshuar nga MPPT):

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP-1	Punime gjurmimi në tokë.
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve
NS-2	Impjante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri mirëmbajtje, etj.
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, etj.
NS-12	Impjante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
NS-14	Impjante të brendëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV, etj.

3. Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij, si më poshtë :

- 1 (nje) - Inxhinier Ndërtimi ose Hidroteknik
- 1 (nje) - Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) - Inxhinier Elektrik

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si më poshtë :

- Licensat profesionale e kolaudimit
- CV

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2018, 2019, 2020 të paraqitura pranë autoritetit përkatës, në të cilat duhet të rezultojë se nuk ka

dale me humbje te pakten ne dy vite te njepasnjeshem. Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve te fundit duhet te mos jete me e vogel se **40%** e fondit limit te procedurës se prokurimit.

b) Operatori Ekonomik duhet të paraqese kopje të deklaratave të xhirove vjetore, vlera mesatare e të cilave nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

Shërbime të ngjashme për shërbimet e mëparëshme të së njëjtës natyrë në një vlerë jo më të vogël se **40 %** e fondit limit të realizuara gjatë tre viteve të fundit.

a. Kur kontrata e së njëjtes natyrë është e realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga autoriteti kontraktor për realizimin e kësaj kontrate ose faturat tatimore për kryejen e shërbimit, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Ose ;

b. Kur kontrata e së njëjtës natyrë është realizuar me individë, persona fizik a juridik jopublike operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore për kryejen e shërbimit, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

4. Operatori Ekonomik duhet të ketë jo më pak se **3 (tre) punonjës** të siguruar për **6 (gjashtë) muajt e fundit** nga data e zhvillimit të tenderit. Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë:

a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, *për 6 (gjashtë) muajt e fundit* nga data e zhvillimit të tenderit.

5. Për llogaritjen e çmimit të ofertës së tyre, Operatorët Ekonomikë duhet të kenë parasysh sa më poshtë:

- Oferta ekonomike duhet të jetë në përputhje me VKM nr.354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim".

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.